



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 4

NR. VENDIMI 298

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTARE: BLERINA MUÇA
GJYQTAR: ASTRIT FAQOLLI
GJYQTARE: TEUTA HOXHA

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Najada Mustafa, në Tiranë, datë 22.01.2019, në séancë të hapur gjyqësore, mori në shqyrtim çështjen civile me Nr.Regj.Them. 4, që u përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS:

***, i biri i *** dhe ***, dtl. ***, lindur në *** dhe banues në ***, përfaqësuar në gjykim nga av. ***, nëpërmjet prokurës së posaçme Nr. ***, si dhe nga av. ***, me deklaram në seancë.

IPADITUR:

Shoqëria ***, me seli ligjore në ***, në mungesë, njoftuar me shpallje.

*Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit, përfaqësuar nga ***, në bazë të Urdhërit Nr. *** datë *** të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, në mungesë në shpalljen e vendimit.*

PALË E TRETË:

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, përfaqësuar nga ***, nëpërmjet autorizimit datë ***, në mungesë.

OBJEKTI:

Detyrimi i palës së paditur të shpërblejë paditësin nga përfitimi ekonomik i përdorimit të pronësisë intelektuale të Patentës nr. *** datë ***, me titull “***”, pronë e tij, në shumën *** Lekë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 1/1, 2/2, 3/1, 4/1, 5, 6, 8, 9/1/a dhe 9/2 pikat “a” dhe “c” të Ligjit Nr. 7819 datë 27.04.1994 “Për Pronësinë Industriale”, Konventa e Parisit “Për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale”, hyrë në fuqi në datë 04.10.1995, Nenet 4, 5 dhe 119/b të Kushtetutës së RSH-së, Kodi i Procedurës Civile.

Gjykata, pasi shqyrtoi çështjen, administroi provat shkresore, në pretendimet përfundimtare, dëgjoi përfaqësuesin e palës paditëse, i cili kërkoi pranimin e padisë sipas objektit të saj, përfaqësuesin e Avokaturës së Shtetit, si përfaqësuese ligjore e ***% të aksioneve shtetërore të ***, e cila kërkoi rrëzimin e padisë, në mungesë të të paditurit dhe personit të tretë,

VËREN

Paditësi ***, ka depozituar padinë në shqyrtim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në datë 02.07.2004, kundrejt të paditurve shoqëria “****” sha dhe ***. Kërkimi fillestar i paditësit, rezultoi të jetë referuar në Ligjin “Për të Drejtën e Autorit”. Me Vendim Nr. *** datë *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është vendosur:

*“Pranimin e padisë së paditësit *** ndaj të dy të paditurve.*

*Detyrimin e të paditurit shoqëria “****” sha, të shpërblejë paditësin *** për shumën *** Lekë, për periudhën Janar deri në fund të Dhjetorit të vitit 2003, si rezultat i shfrytëzimit prej saj të shpikjes së paditësit “Skema e kthimit të vajit mbetës të reaktorëve në solar të pastër...”*

*Gjykata e Apelit Vlorë, me Vendim Nr. *** datë *** , ka vendosur:*

*“Prishjen e Vendimit Nr. *** datë *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.”*

*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier në rigjykim, me Vendim Nr. *** datë *** , ka vendosur:*

“Moskompetencën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke i dërguar aktet gjykatës kompetente, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

*Ky vendim, rezultoi të jetë lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, me Vendim Nr. *** datë ***.*

Gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, paditësi ka hequr dorë nga thirrja në cilësinë e të paditurit të ***, si dhe ka saktësuar vlerën e objektit të padisë dhe referencën e saj ligjore, duke kërkuar përfundimisht shpërblimin nga i padituri “****” sha, për përfitimin ekonomik të realizuar prej tij, nga përdorimi i pronësisë intelektuale të Patentës nr. *** datë *** , me titull ***, në pronësi të paditësit, në shumën *** Lekë.

Kjo çështje ka qëndruar e pezulluar me Vendim Nr. *** Akti datë *** dhe me Vendim Nr. *** Akti datë *** , deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes së themelit, me Palë Paditëse: Shoqëria “****” sha; Të paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, ***; Objekti: “Shfuqizim i Patentës nr. *** datë *** , me titull ***.

Me Vendim Nr. *** datë *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me Vendim Nr. *** datë *** të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është vendosur: “Rrëzimi i

padisë së shoqërisë “****” sha.”

Me Vendim Nr. *** datë *** të Gjykatës së Apelit Tiranë, u konsiderua i rënë shkaku i pezullimit të gjykimit, me marrjen formë të prerë të Vendimit Nr. *** datë *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe u vendos rifillimi i gjykimit të çështjes.

Fakti i provuar në gjykim:

Shoqëria shtetërore “****” sha, figuron e regjistruar në Regjistrin Tregtar në datë ***, me aksioner të vetëm Shtetin Shqiptar, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës. Me Kontratën për Blerje Aksionesh me Nr. *** datë ***, është realizuar kalimi i ****% të aksioneve të shoqërisë, konsorciumit “****”. Aktualisht, Shteti vijon të jetë aksioner me ****% të aksioneve në këtë shoqëri.

Paditësi ***, ka qënë i punësuar pranë shoqërisë “****” (***), në detyrën Teknik Teknolog në Repartin e Koksifikimit që nga viti 1970 e në vijim. Në vitin 1990, rezulton që paditësi të ketë realizuar studimin shkencor “Mbi Mbetjet Teknologjike të Reaktorëve Termik në ****”, i pasqyruar në Nr. 103, të Librit të Propozimeve të Punonjësve, pranë Byrosë Teknologjike të vitit 1990, me titull “Përdorimi i vajit të kamerave për solar të gatshëm”. Ky novacion i paditësit, është vënë në zbatim nga punëdhënësi, në procesin e koksifikimit të mazutit, duke u arritur që, mbetjet e këtij procesi teknologjik, deri atëherë të papërdorshme, të eliminoheshin, duke përfutur solar të pastër nga reaktori termik. Paditësi pretendon se, për këtë novacion, ai nuk ka përfutur asnjë shpërblim nga punëdhënësi, në një kohë që, aplikimi i këtij novacioni në vënd të skemës së vjetër teknologjike, ka sjellë një përfitim ekonomik tepër të lartë për të paditurin.

Nga Drejtorja e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, në datë 10.05.2004, është lëshuar Patenta Për Shpikje me Nr. ***, në emër të pronarit ***, “****” sha, për shpikjen me titull “Skema e kthimit të vajit mbetës të reaktorëve në solar të pastër”. Kjo patentë, rezulton të jetë publikuar në Gazetën e Patentave dhe Markave Nr. ***, datë ***, në bazë të Ligjit Nr. 7819 datë 27.04.1994 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar.

Paditësi i është drejtuar me shkresë ***, duke kërkuar të drejtat e tij ekonomike që rrjedhin nga kjo patentë. Me shkresën nr. *** prot. datë ***, *** e ka vënë në dijeni paditësin se, dokumentacioni përkatës është dërguar për trajtim, pranë qendrës së personit juridik “****” sha. Nuk rezulton që nga i padituri të jetë kthyer përgjigje në lidhje me këtë kërkesë të paditësit.

Gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, i padituri ka prapsuar vlefshmërinë e patentës së regjistruar në pronësi të paditësit, duke pretenduar se, në bazë të VKM Nr. 176 datë 25.05.1990 “Për fondin e shpërblimeve për novacione dhe racinalizime”, paditësi është shpërblyer për novacionin e realizuar përgjatë marrëdhënies së punës, por dokumentacioni provues për këtë fakt, nuk disponohej, për shkak të situatës së jashtëzakonshme të asaj kohe.

Me shkresën nr. *** prot. datë ***, miratuar nga Drejtori i ***, përpiluar nga Specialisti i Degës Teknologjike, K/Degës së Programimit dhe K/Inxhinieri i ***, sqarohet sa më poshtë:

“Në vitin 1978 deri në vitin 1990, kondesati vajor ose vaj kamerash, si produkt i depozituar në fundin e kamerave të koksit, dërgohej në rezervuaret e produkteve të rënda jashtë standartit të objektit 16/2 dhe konkretisht në G-35 dhe G-36... Me novacionin apo racionalizimin e bërë në atë periudhë, u bë i mundur bashkimi i vajit kondesat të kamerave të koksit me distilin e solarit, i cili është prodhim i kollonës T-202 të Repartit të Koksit dhe depozitimi i tyre në rezervuarin G-33 të objektit 16/2. Bashkimi i vajit kondesat me distilin e solarit u realizua mbasi u mundësua largimi i mbeturinave mekanike dhe ujit të lirë nga vaji i kamerave, proces ky që më parë kryhej në rezervuaret G-35 dhe G-36... Novacioni apo racionalizimi u aprovua dhe u vu për zbatim mbasi krijon lehtësi teknologjike në sektorin e përgatitjes së solarit të gatshëm...”

Shoqëria “****” sha, në datë 13.09.2005, ka depozituar në Gjykatë padinë për pavlefshmërinë e patentës për shpikje të regjistruar në pronësi të paditësit ***. Pas pushimit të gjykimit të kësaj padie, nga ana e shoqërisë është riparaqitur e njëjta padi në gjykatë në datë 07.10.2011. Me Vendimin Nr. *** datë *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin Nr. *** datë *** të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është vendosur rrezimi i padisë së shoqërisë “****” sha. Në atë gjykim, rezultoi të jenë parashtruar të gjitha prapsimet dhe pretendimet e shoqërisë, në drejtim të pavlefshmërisë së patentës në pronësi të paditësit, të cilat, në kushtet e parashkrimit të padisë, nuk janë marrë në shqyrtim dhe nuk janë analizuar nga ana e gjykatës. Në këto kushte, shoqëria “****” sha, ka humbur të drejtën e realizimit të së drejtës së saj të pretenduar për pavlefshmërinë e patentës objekt gjykimi nëpërmjet gjykatës, duke mbetur në këtë mënyrë në fuqi e drejta e pronësisë së paditësit *** mbi këtë patentë.

Për rrjedhojë të sa më lart, objekti i shqyrtimit gjyqësor në këtë gjykim, janë të drejtat e paditësit, që rrjedhin nga pronësia e tij mbi Patentën me Nr. *** datë *** “Skema e kthimit të vajit mbetës të reaktorëve në solar të pastër”, e cila edhe aktualisht shfrytëzohet prej palës së paditur. Nga pala paditëse u kërkua vlerësimi i shpërblimit të kërkuar në këtë gjykim, nëpërmjet përlllogaritjes së efektit ekonomik/leverdisë ekonomike që patenta në pronësi të tij, ka sjellë në aktivitetin e palës së paditur në vite, duke u krahasuar me gjendjen e këtij aktiviteti, para vënies në shfrytëzim të patentës në pronësi të paditësit.

Për këtë qëllim, në gjykim u thirr me cilësinë e ekspertit teknik, ing. ***, i cili realizoi aktin e ekspertimit datë 06.06.2011 dhe shtesën e aktit datë 27.09.2011, si dhe ekspertja kontabël ***. Nga përgjigjet e ekspertit teknik konfirmohet sa më poshtë:

- *Shpikja me titull “Skema e kthimit të vajit mbetës të reaktorëve në solar të pastër”, për të cilën është dhënë Patenta me Nr. *** datë ***, është vënë në zbatim, duke u përdorur në procesin teknologjik në Repartin e Koksifikimit të ***, nga muaji Maj 1990 dhe vazhdon edhe aktualisht;*

- Si rrjedhojë e vënies në zbatim të kësaj skeme, përftohet rreth 30 ton solar i pastër në ditë;
- Avantazhet e përdorimit të Patentës, krahasuar me skemën e vjetër teknologjike të projektuar dhe zbatuar nga specialistët kinezë, janë:
 - - Prodhimi i solarit të pastër si produkt i gatshëm direkt nga reaktori i koksifikimit të vonuar, i cili bashkohet direkt me distilatin e solarit të pastër, prodhim i kolonës së distilimit T-202 të Repartit të Koksifikimit;
 - - Në zvogëlimin e sasisë së produkteve të rënda dhe mbetjeve teknologjike;
 - - Në uljen e humbjeve dhe kostos së prodhimit për njësi produkti në bilancin e përgjithshëm të *** për riciklimin e këtyre produkteve;
 - - Në uljen e kostos së prodhimit, rritjen e rendimentit dhe uljen e humbjeve në Repartin e Koksifikimit të vonuar;
 - - Në rritjen e sasisë së solarit të pastër me 30 ton në ditë, i cili përdoret për nevoja specifike industriale dhe rezidenciale;
 - - Në largimin e karboideve, mbeturinave mekanike dhe ujit të lirë nga vaji i kamerave, proces i cili më parë kryhej në rezervuarët G-35 dhe G-36 të objektit 16/2;
 - - Në uljen e përbërësve karboid dhe mbetjeve të rënda në lëndën e parë naftë bruto, e cila do të ndikonte në koksifikimin e tubave të furrave, në bllokimin e aparateve të shkëmbimit të nxehtësisë dhe pjatave të kolonave rektifikuese;
 - - Skema e re është një skemë e shkurtër, që ka në përbërje të saj elementë teknologjik, të cilat skema e vjetër nuk i ka patur;
 - - Në zvogëlimin e impaktit mjedisor;
 - - Në kursimin e gazoilut të koksit, i cili përdoret për bleding, afërsisht në të njëjtën sasi me mbetjen e kondensatit të reaktorëve të koksifikimit;
 - Ndryshimet midis skemës së re teknologjike me skemën e mëparshme:
 - - Në rikonceptimin dhe ndryshimin e parametrave teknologjik të bllokut të reaktorëve të koksifikimit të vonuar;
 - - Në ndryshimin e regjimit të punës së reaktorëve të koksifikimit gjatë futjes së gazit për parangrohje dhe tërheqjes së kondensatit nga reaktorët;
 - - Në rikonceptimin dhe ndryshimin e detyrave dhe përgjegjësi që kanë Përgjegjësi i Turnit, Teknologët e Bllokut të Reaktorëve dhe Pompisti i Pompës B-212, në përputhje me kryerjen e operacioneve teknologjike sipas skemës së re;
 - - Në infrastrukturën teknike, që mundëson realizimin e skemës së re, e cila është realizuar duke futur në punë vetëm për këtë qëllim, një seksion të ftohësit L-208, duke shfrytëzuar plotësisht linjën “e vdekur” egzistuese të 5% të mazutit, si dhe duke shtuar një linjë të re në skemën teknologjike;
 - Në kushtet e refuzimit total të palës së paditur për vënien në dispozicion të kryerjes së ekspertimit, të dokumentacionit të nevojshëm, ekspertimi u krye duke u bazuar, veç akteve në dosje, edhe në materialet e publikuara nga METE, AKPN dhe INSTAT.

Nga pala e paditur, pas realizimit të ekspertimit teknik dhe pezullimit të gjykimit, nuk u tregua interes për vijimin e këtij gjykimi. Nga përfaqësuesit e kësaj pale deri në këtë moment procedural, u deklarua heqja dorë nga përfaqësimi. Për rrjedhojë, u vijua me njoftimin e të

paditurit në adresën e selisë ligjore, sipas të dhënave të publikuara në QKR. Në kushtet kur në këtë adresë, rezultoi shënimi i postës “Larguar”, nga ana e Gjykatës iu kërkua MZHETTS, si aksioner me ***% të aksioneve të shoqërisë “****” sha, informacion në lidhje me një adresë të saktë të selisë së saj dhe në lidhje me vijimin e veprimtarisë së kësaj shoqërie. Në kushtet kur, edhe në këtë adresë rezultoi shënimi i Postës “Ka ndryshuar adresë”, Gjykata vijoi me njoftimin e të paditurit me shpallje publike, e barasvlefshme me njoftimin e rregullt procedural në një gjykim civil.

Në kushtet sa më lart, gjykimi i kësaj çështje vijoi në mungesë të të paditurit, njoftuar me shpallje publike. Mosmarrja pjesë e kësaj pale në gjykim, u shoqërua dhe me zvarritje dhe pengesa në drejtim të realizimit të aktit të ekspertimit kontabël, në funksion të të cilit, ishte e detyrueshme vënia në dispozicion i gjithë dokumentacionit financiar të shoqërisë. Nga ana e Gjykatës u ezauruan përpjekjet për tërheqjen e një informacioni zyrtar nga pala e tretë DPPM, në lidhje me faktin nëse pranë këtij institucioni disponoheshin kontrata të shfrytëzimit të patentave të ngjashme me patentën objekt gjykimi, me qëllim përcaktimin e vlerës së përdorimit të kësaj patente sa më afër realitetit. Nga ana e DPPM-së, me shkresën nr. *** prot. datë ***, iu bë me dije Gjykatës ekzistenca pranë saj e kontratave të liçensës për patenta dhe shpikje, të cilat janë ndërkombëtare, të cilat, për arsye konfidenciale, nuk tregojnë vlerën e shitjes apo të dhëna për përdorimin e patentës.

Në këto kushte, u vijua përllogaritja e vlerës së dëmshpërblimit të kërkuar nga ana e paditësit, nëpërmjet ekspertimit kontabël, mbi provat që u mundësuan gjatë këtij gjykimi. Nga ana e ekspertës kontabël, mbi formulat dhe parametrat e bëra prezent nga eksperti teknik, u realizua përllogaritja e përfitimit ekonomik të “****” sha, nga shfrytëzimi i Patentës Nr. ***, në pronësi të paditësit ***. Për realizimin e këtij akti ekspertimi, pas refuzimit të palës së paditur për të vënë në dispozicion të gjykimit dokumentacionin financiar të nevojshëm, në bazë të nenit 223 të K.Pr.Civile, u bënë përpjekje të vazhdueshme nga Gjykata për sigurimin e të dhënave të nevojshme nga institucionet shtetërore të ngarkuara me ligj, duke u arritur të admnistrohet në gjykim, Raporti i Kontrollit të Drejtorisë Rajonale të Njësisë së Tatim Paguesve të Mëdhenj, pranë “****” sha, me Nr. *** prot. datë ***, i cili i përket periudhës ushtrimore nga Janar 2011 - Gusht 2013. Nga përllogaritjet e kryera nga ekspertja kontabël, rezulton vlera e përfitimit ekonomik të shoqërisë “****” sha nga vënia në shfrytëzim e patentës në pronësi të paditësit, përgjatë periudhës 18.06.2004 deri në Gusht 2013, në shumën *** Lekë. Paditësi, pas shtimit të vlerës së objektit të padisë në vlerën e mësipërme, nuk realizoi pagimin e taksës gjyqësore mbi këtë shtesë, duke i qëndruar në përfundim kërkimit të dëmshpërblimit në shumën *** Lekë.

Përfundime të Gjykatës:

Në analizë të fakteve të mësipërme dhe përcaktimeve ligjore specifike të fushës së pronësisë industriale, Gjykata në përfundim të gjykimit e gjen padinë e paditësit *** të mbështetur në prova dhe në ligj, duke arsyetuar:

Referencë e zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim, janë përcaktimet

specifike ligjore në fushën e pronësisë industriale, konkretisht:

Ligji Nr. 7819 datë datë 27.04.1994 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8477 datë 22.04.1999, si dhe Ligji Nr. 9947 datë 07.07.2008, i ndryshuar.

Rregullimi i parë ligjor në drejtim të mbrojtjes të së drejtës së patentave, është bërë nëpërmjet Ligjit Nr. 7819 datë 27.04.1994, në kushtet kur deri në këtë moment, kjo fushë rregullohej sipas dispozitave të Kodit Civil të vitit 1981, Kreu VII, nenet 329 e vijues të tij, në kuadër të pronësisë shtetërore. Sipas këtyre dispozitave, autori i një shpikje (zgjidhja e një problemi teknik në çdo fushë të ekonomisë ..., që karakterizohet nga elemente të reja thelbësore dhe që jep rezultate pozitive), pajisej me dëshmi autori, e cila në çdo rast jepej nga ministria ose institucioni tjetër qëndror. E drejta e shfrytëzimit të shpikjes, në referim të nenit 332 të këtij kodi, i takonte shtetit, ndërsa autori i saj, shpërblehej në bazë të kriterëve të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

Në çështjen në shqyrtim, provohet fakti që, nga pala paditëse, në vitin 1990, në kuadër të marrëdhënies së punës që ekzistonte mes tij dhe të paditurit, është realizuar studimi shkencor “Mbi Mbetjet Teknologjike të Reaktorëve Termik në ****”, i pasqyruar në Nr. 103, të Librit të Propozimeve të Punonjësve, pranë Byrosë Teknologjike të vitit 1990, me titull “Përdorimi i vajit të kamerave për solar të gatshëm”. Provohet gjithashtu fakti që ky novacion i paditësit, është vënë në zbatim nga punëdhënësi, në procesin e koksifikimit të mazutit, duke u arritur që, mbetjet e këtij procesi teknologjik, deri atëherë të papërdorshme, të eliminoheshin, duke përfutur solar të pastër nga reaktori termik. Nga provat e administruara, si dhe nga qëndrimi i palës së paditur gjatë gjyqimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, nuk provohet që paditësi të jetë shpërblyer në atë kohë për shpikjen e realizuar dhe të vënë në shfrytëzim.

Nga ana e paditësit, rezulton që kjo shpikje, të jetë regjistruar në DPPM në pronësi të tij, nëpërmjet Patentës me Nr. *** datë *** “Skema e kthimit të vajit mbetës të reaktorëve në solar të pastër” dhe, gjatë gjithë kohës është shfrytëzuar prej palës së paditur në proceset e veta teknologjike. Procedurat për regjistrimin e kësaj patente, kanë qënë rregulluar nëpërmjet përcaktimeve të Ligjit Nr. 7819 datë datë 27.04.1994 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8477 datë 22.04.1999. Në nenet 27 e vijues të këtij ligji, rregullohen të drejtat që i njeh një patentë e regjistruar mbajtësit të saj, kundrejt të tretëve, ndërsa në nenet 41 - 43 të ligjit, rregullohen rastet e shkeljeve të të drejtave që rrjedhin nga e drejta e patentës, të cilat merren në shqyrtim nga gjykata, mbi kërkesën e pretenduesit.

Në këtë mënyrë, e drejta e paditësit në këtë gjykim, si mbajtës i Patentës Nr. ***, veç dispozitave të mësipërme, gjen mbështetje edhe përcaktimet e nenit 9 të këtij ligji, i cili rregullon marrëdhëniet mes të punësuarit dhe punësuesit, për një shpikje të realizuar përgjatë marrëdhënies së punësimit. Në interpretim të kësaj dispozite, për analogji me situatën faktike të çështjes, në rastet e realizimit të një shpikje nga punëmarrësi, jashtë marrëveshjes me punëdhënësin apo kontratës së punës, nëse punëdhënësi shpreh interesin për këtë shpikje, e drejta për patentë i përket këtij të fundit, kundrejt detyrimit të tij për të shpërblyer punëmarrësin, në raport me pagën e tij, me vlerën ekonomike të shpikjes, si dhe me

përfitimim që punëdhënësi merr nga kjo shpikje. Në rast të mungesës së marrëveshjes mes palëve, masa e shpërblimit caktohet nga gjykata. Në rastin konkret, megjithëse provohet fakti që shpikja e paditësit, e cila më pas është patentuar, është shfrytëzuar dhe vijon të shfrytëzohet nga i padituri ish-punëdhënësi, rezulton që ky i fundit të mos ketë shpërblyer paditësin në asnjë moment, si në kohën e kryerjes së shpikjes dhe vënies së saj në shfrytëzim, sipas rregullave në fuqi në atë kohë, ashtu edhe në momentin kur paditësi këtë shpikje e ka regjistruar në pronësi të tij. Megjithë përpjekjet ligjore të palës së paditur për shfuqizimin e kësaj patente, me vendim të formës së prerë gjyqësor, provohet të jenë rrëzuar të gjitha pretendimet e kësaj pale, duke mbetur e pacënuar e drejta e pronësisë së paditësit mbi Patentën me Nr. ***.

Me ndryshimet që pësoi legjislacioni në fushën e pronësisë industriale, nëpërmjet Ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008, në nenin 15 të tij, rezulton i njëjti rregullim ligjor, përsa i përket të drejtës së punëmarrësit, që ka realizuar një shpikje jashtë kuadrit të një kontrate apo marrëveshje pune, për t'u shpërblyer nga punëdhënësi, i cili posedon shpikjen e këtij punëmarrësi. Konkretisht, neni 15 i këtij ligji, përcakton:

Shpikja nga një punëmarrës

1. Nëse një shpikje është bërë në kuadër të një kontrate ose marrëveshjeje pune:

- a) e drejta për patentë i përket personit, që porositi kryerjen e saj ose punëdhënësit, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratë;***
- b) kur shpikja ka një vlerë ekonomike shumë më të lartë nga ajo, që palët kishin parashikuar në kohën e nënshkrimit të kontratës së punës, punëmarrësi ka të drejtën e një kompensimi të veçantë. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve për vlerën e kompensimit, kjo vendoset nga gjykata.***

2. Kur një punëmarrës, edhe pse kontrata e punës nuk e detyron të merret me veprimtari shpikëse, bën një shpikje, duke përdorur të dhëna dhe mjete të tjera, që i bëhen të njohura nëpërmjet punësimit të tij:

- a) e drejta për patentë për këtë shpikje i përket punëmarrësit, përveç rasteve, kur brenda një periudhe prej katër muajsh nga data kur raporti, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij neni, i është paraqitur punëdhënësit, ose nga data kur punëdhënësi është njoftuar për shpikjen në mënyra të tjera, duke filluar nga data më e hershme prej këtyre datave, punëdhënësi njofton punëmarrësin nëpërmjet një deklarate me shkrim se është i interesuar për shpikjen;***
- b) ky punëmarrës, që ka bërë shpikjen, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 2 të këtij neni, duhet t'i paraqesë punëdhënësit menjëherë një raport me shkrim për shpikjen;***
- c) nëse brenda periudhës së përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij neni, punëdhënësi lëshon një deklaratë, ku shpreh interes për shpikjen, atëherë e drejta për patentë i përket punëdhënësit, që nga fillimi. Në varësi të pagës, vlerës ekonomike të shpikjes dhe fitimit, që punëdhënësi siguron nga shpikja, punëmarrësi ka të drejtën e kompensimit. Nëse palët nuk bien dakord për vlerën e kompensimit, ajo do të vendoset nga gjykata.***

3. Çdo kontratë, që është më pak e favorshme për shpikësin se parashikimet e këtij neni,

është e pavlefshme.”

Veç përcaktimeve të mësipërme ligjore, edhe Kodi i Punës i miratuar me Ligjin Nr. 7961 datë 12.07.1995, i ndryshuar, në nenin 135 të tij, parashikon detyrimisht marrëveshjen mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, për një shpikje të realizuar prej këtij të fundit, jashtë kryerjes së detyrimeve të tij kontraktore. Pavarësisht mungesës së provueshmërisë në këtë gjykim, në drejtim të afateve të njoftimit dhe të deklarimit të palëve, në gjykim konfirmohet fakti që, shpikja e paditësit, nuk rezulton të ketë qënë kryer në kuadër të detyrimeve të tij kontraktore të punës. Po kështu, provohet që punëdhënësi ta ketë fituar këtë shpikje, nëpërmjet vënies së saj në shfrytëzim, që në momentin e realizimit të saj. Për rrjedhojë, pala paditëse gëzon të drejtën e shpërblimit, veç përcaktimeve të mësipërme ligjore, edhe në bazë të përcaktimeve të pikës 4 të nenit 135 të Kodit të Punës, sipas së cilës:

“Nëse shpikja nuk i lihet punëmarrësit, punëdhënësi i paguan atij një shpërblim të drejtë, duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat, vlerën ekonomike të shpikjes, bashkëpunimin e punëdhënësit dhe të ndihmësave të tij, përdorimin që i është bërë pajisjeve të tij, shpenzimet e punëmarrësit dhe vendin e tij në ndërmarrje.”,

Në gjykim, megjithë vështirësitë e hasura për përlllogaritjen e vlerës ekonomike të shpikjes/patentës së regjistruar në pronësi të paditësit, u arrit në përfundimin se, impakti i kësaj shpikje në veprimtarinë e palës së paditur të ketë qënë i konsiderueshëm, në raport me situatën përpara vënies së saj në shfrytëzim. Nga pala paditëse gjatë gjykimit, u kufizua vlera e kërkimit në shumën *** Lekë, megjithëse përfitimi ekonomik i të paditurit ishte disa herë më i lartë.

Nga sa më lart, në përfundim të gjykimit, Gjykata e gjen padinë e paditësit *** tërësisht të mbështetur në prova dhe në ligj dhe si të tillë e pranon atë.

PËR KËTO ARSYE
Konform nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile

VENDOSI

- Pranimin e padisë së paditësit ***.
- Detyrimin e palës së paditur, Shoqëria “****” sha t’i paguajë paditësit *** shumën *** Lekë, si shpërblim për përdorimin e Patentës me Nr. *** datë ***, me titull ***, në pronësi të tij.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.
- Për këtë vendim, lëshohet urdhër ekzekutimi sipas përcaktimeve të nenit 310/1 të K.Pr.C i ndryshuar.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brënda 15 ditëve nga e nesërmeja e shpalljes. Për palët në mungesë, ky afat fillon nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit.

Tiranë, më 22.01.2019

**GJYQTARE
GJYQTARE**

**TEUTA HOXHA
MUÇA**

GJYQTAR

ASTRIT FAQOLLI

BLERINA

SEKRETARE

NAJADA MUSTAFA

Shpenzimet gjyqësore

<i>Shpenzime pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier</i>	<i>206.500 Lekë</i>	
<i>Taksë shtesë padie</i>		<i>225.000 Lekë</i>
<i>Shpenzime ekspertimi teknik</i>	<i>1.200.000 Lekë</i>	
<i>Shpenzime ekspertimi kontabël</i>	<i>180.000 Lekë</i>	
<i>Njoftime (për Gjykatën)</i>		<i>800 Lekë</i>